



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:236216

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05431634

C.nr.194/2011

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile sipas padisë së paditësit B. U., nga Prishtina, me vendbanim në rrugën "...", nr. ..., përfaqësuar me autorizim nga B. T., avokat në Prishtinë, kundër të paditurve Sh. A., nga Prishtina, përfaqësuar me autorizim nga O. H., avokat në Prishtinë, dhe B. K.T., me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga A. S., sipas autorizimit, me objekt të shqyrtimit anulimin e kontratës së hipotekës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më datës 20.02.2024, më datë 29.02.2024, dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit B. U., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet kontrata e hipotekës e lidhur në mes të paditurve Sh. A., nga Prishtina dhe B. K. T., me seli në Prishtinë, nr..., e datës 20.12.2008, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me numër ..., datë 24.12.2008, dhe të obligohet Komuna e Grapanicës që t'ia anuloj të gjitha veprimet procedurale të cilat janë ndërmarr si pasojë e ekzekutimit të kësaj kontrate.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta te procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurve, me objekt të kontestit anulimin e kontratës së hipotekës, me të cilën ka kërkuar anulohet kontrata e hipotekës e lidhur në mes të paditurve Sh. A., nga Prishtina dhe B. K. T., me seli në

Prishtinë, nr..., e datës 20.12.2008, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me numër Vr.nr..., datë 24.12.2008, dhe të obligohet Komuna e Graçanicës që t'ia anuloj të gjitha veprimet procedurale të cilat janë ndërmarr si pasojë e ekzekutimit të kësaj kontrate.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me padi, seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se Pas analizimit, dhe sintetizimit të teresishem, të pretendimeve dhe arsytimit të paditësit, deklaratave konfuze të paditurit Sh. A., deklaratës së dëshmitarit R. A., rezulton se: Gjate vitit 2008, B. U., Sh. A. dhe R. A., kanë pasur marrëveshje për të ndërtuar një objekt të përbashkët afarist në Prishtinë, me gjerësisht deklaratë të dëshmitarit R. A. e dhen në seancën e datës 20 02 2024, e cila deklarate u pranua edhe nga Sh. A. B. U., e ka nënshkruar në gjuhën shqipe, autorizimin e përgatitur nga i padituri Sh. A. ose ndihmësit e tij profesional, e të cilin autorizim në mirëbesim që është autorizim ekskluziv për kredi për biznesin e përbashkët, me Sh. A. dhe R. A. Sh. A. e ka keqpërdor autorizimin e B. U., ka marrë kredi private. Sh. A. e ka keqpërdor autorizimin e B. U. dhe ka vënë në lajthim Bankën, dhe i ka kryer dy vepra penale. Keqpërdorim i besimit respektivisht keqpërdorim i autorizimit ndaj B. U. Mashtrim ndaj bankës, pasi që i ka prezantuar autorizimin i dhënë për qëllim biznesi. Për shkak të deklaratimit jo të saktë të adresës, dhe shmangies nga organet e drejtësisë, nga Sh. A. por dhe për faktin se prokuroria gabimisht e ka anashkaluar faktin që kemi vetëm vepra penale të mashtrimit ndaj B. U. Si rezultat i kualifikimit të gabuar të prokurorisë ka përfituar Sh. A. Sepse në veprimet e Sh. A. dy vepra penale: Keqpërdorim i besimit respektivisht keqpërdorim i autorizimit ndaj B. U. dhe Mashtrim ndaj bankës, pasi që i ka prezantuar autorizimin i dhënë për qëllim biznesi. Sh. A., Gjate kohës sa ka zhvilluar bisedime me B. U. dhe R. A. për të ndërtuar një objekt të përbashkët afarist në Prishtinë. B., dhe autorizimin e dërgon në banke për kredi private dhe hipotekë të motrës së b., ku besimi formalisht ishte pronar. Dhe menjëherë i njofton partneret afarist B. U. dhe Sh. A., se pronari i tokës e ka ngritur çmimin dhe nuk po e është pronë. Me këtë është prolonguar zbatimi i marrëveshjes për bashkëndertim. Keqpërdorimi i besimit nga Sh. A. konstatohet me faktet: Sh. A. në fillim të dhjetorit 2008, ose me herët ka aplikuar për kredi private në B. K. T. Me datë 17 12 2008, është vërtetuar autorizimi i B. U. për Sh. A. për kredi të përbashkët biznesi. Me datë 18 12 2008, Sh. A. i ka njoftuar partneret B.

U. dhe R. A. : Qe pronari i tokës nuk po e shete token. Me date 20 12 2008, Sh. A. e ka nënshkruar kontratën për kredinë dhe hipotekën. Sh. A. , vetëm dy-tre rata te kredisë, i ka paguar, e te tjerat jo. Kjo rrethane e vërteton qëllimin e keqpërdorimit te besimit/autorizimit. e kontratës. Sh. A. ne realizimin e keqperodimit se hipotekës, e kanë ndihmuar zyrtaret e bankës: A. I. dhe D. B. Zyrtari D. B., me vonë ne funksionin e përmbauesit Privat e ka bere përmbauesin, ne demin e debitorit B. U. B. U., ne muajin nëntor 2010 është njoftuar qe B. Është pronar, është vene ne hipotekës, nga Sh. A. B. U. e ka anuluar autorizimin, e aktin Ob.br..., te datës 17 janar 2011 e ka anuluar, autorizimin Vr.nr... , te datës 17.12.2008, me efekt nga date 17 12 2008, qe ne fakt i ka anuluar te gjitha veprimet e Sh. A. te ndërmarra ne emër te B. U. dhe ne llogari te pronës ku B. U. eshte pronar. B. U. ke denoncuar Sh. A. për keqpërdorim te autorizimit Vr.nr... , te datës 17.12.2008, IX. Pretendimet dhe deklaratat e paditësit, u vërtetuan nga deklarata e dëshmitarit R. A.

I padituri, përmes të autorizuarit të tij, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se sa i përket ngritjes së Padisë në gjykatë për nulimin e Kontratës së kredisë më së miri e ka sqaruar pala e paditur BKT. Përfaqësuesi i sajë A. S. ka konfirmuar se kredia e marë nga ana e të paditurit Sh. A., ka qenë në rregull ,konform ligjit dhe rregullave bankare. Ai ka thënë se Autorizimi i cili doli të jetë qështje e trajtimit të ti në këtë gjykatë është vërtetuar se ai ishte në rregull të cilin e ka dhënë dhe nënshkruar në gjykatë paditësi B. U. Ka thënë se ky autorizim i është dhënë Sh. A. nga tani paditësi B. e që në përmbajtjen e ti nuk është vërejtur ndonjë kufizim i cili do ta pengonte vurrjen e palujtëshmerive të B. U. dhe të Sh. A. në Hipotekë. Lidhur me këtë ai ka pohuar se BKT ka arrijt ti hedh poshtë të gjitha pretendimet e palës paditëse si të pa bazuara. Për këtë qështje, përveç provave të prezantuara të cilat i ka gjykata nga Banka nuk është vu fare në dyshim ndonjë parregullësi e tyre,të cilën e ka pohuar edhe vet përfaqësuesi i bankës. Ai ka thënë së Autorizimi i vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës VR.nr... i datës 17.12.2008 është plotësisht në rregull sikurse edhe Kontrata e Kredisë Bankare me numër ... e datës 20.12.2008 është e bazuar në prova materjale (dëshmi fletat poseduese) të cilat nuk mund të kontestohen fare. Njëherit është evidente se në aspektin e përmbushmërisë së detyrimeve ndaj bankes nga Sh. A. lidhur me dinamikën e pagesave, ka pasë ngecje, dhe për këtë kjo për faktin se nuk shprehte

gatishmëri pala paditëse që bashkarisht ti përmbushin obligimet mujore ndaj BKT respektivisht të paguajnë ratat mujore me rregull ashtu siq kan qenë të përcaktuara. Sa i përket, mënyrës dhe qellimit të marjes së kësaj kredie, më së miri e ka argumentuar vet i padituri Sh. A., në seancën e fundit të mbajtur me 20.02.2024. Gjykata Aktgjykimin e vet do ta mbështes edhe në këtë procesverbal (20.02.2024)andaj ne nuk do ti përshkruajmë edhe një herë zhvillimet e ngjarjeve ,por nuk do të lëmë pa permendur se; vurja në hipotek e pasurisë së paluajtëshme e Sh. A. (sipas fletës poseduese) dhe ajo e B. U. është bërë me qellim të përbashkët ashtu që pas marje së kredisë, të hollat ti ndajnë për gjysëm 50:50 e njashtu edhe në përmbushjen e detyrimeve -ratave të kredisë ti paguajnë bashkarisht. Mjetet pas terheqjes në bankë nga Sh. A., ato janë nda për gjysmë me B. U., por ai ka ngecur në përmbushjet të detyrimeve të ti, ashtu që tani e kemi nje gjendje bllokimit të pagesave dhe rritjes enormë të kamatës ndëshkuese nga ana e bankës. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, banka ka lënë mundësin në përmbushje të obligimeve të ngelura. Kur kemi para syshë se BKT në gjykatë me datë 09.02.2021 ka deponuar komplet dosjen e kredisë me Numrin e protokolit të tyre ... e datës 09.02.2021, shofim se është e pa nevojshme ti ripërserisim dhe potencojmë edhe një herë një mori dëshmi, sepse të gjithë ne si palë i kemi sikurse edhe gjykata. I ka propozuar gjykatës Që Padia dhe kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar, duke kërkuar të gjitha shpenzimet e bëra për këtë proces dhe atë sipas Tarifës së OAK-së.

E paditura B. K. T., me seli në Prishtinë, përmes të autorizuarit të saj, me përgjigje në padi, seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Ka shtuar se paditësi nuk ka arritur që me asnjë provë të e bëj të besueshme pretendime e tij. nuk është prezantuar asnjë provë e cila autorizimin ose kontrata objekti kontesti i bën të pavlefshme. Më tej ka shtuar se para nënshkrimit të kontratës së kredisë dhe të hipotekës, e paditura kishte ndjekur të gjitha procedurat e përcaktuara ligjore. Fillimisht, kishte kërkuar që autorizimi me të cilin do të nënshkruhen kontrata e hipotekës të jetë i vërtetuar në gjykatën kompetente, gjë e cila edhe kishte ndodhur. Autorizimi me të cilën ishte lidhur kontrata mbi hipotekën ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Autorizimi në përmbajte është specifik, konkret dhe i qartë, duke i dhënë tagër të autorizuarit që parcelat e autorizim dhënësit me numër të

ngastrës ... dhe ... ZK S., mund të i vej në hipotekë në bankë me qëllim të marrjes së kredisë. Pra, nga përmbajtja e autorizimit konsiderohet se i autorizuari ka pas tagër të plotë që paluajtshmëritë e lartcekura që i vendos si hipotek në bankë me qëllim të marrjes së kredisë. Pastaj, kontrata e hipotekë është vërtetuar në gjykatën kompetente, përkatësisht në Gjykatën Komunale në Lipjan. Përfundimisht, gjatë shqyrtimit gjyqësor por edhe të parashtrësive të dorëzuara në gjykatë, paditësi nuk ka arritur që me asnjë dispozitë apo provë të e vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë. Padia nuk ia referohet asnjë dispozite të ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Nga këto të cekurat i ka propozuar gjykatës që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Kontrata e Kredisë Bankare Nr... , datë: 20.12.2008, Kontrata e Hipotekës Nr... , datë: 20.12.2008, për pronën e B. U., Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Lipjanit, VR.NR. ... , datë: 23.12.2008, Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës, nr. i protokollit: 1436/08, datë: 26.12.2008, Kontrata e Hipotekës Nr... , datë: 20.12.2008, për pronën e Sh. A., Vërtetimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë VR.NR... , datë: 24.12.2008, Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës, nr. i protokollit: ..., datë: 26.12.2008, Autorizim i B. U., i vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë Vr.nr... , datë: 17.12.2008, Certifikata e Regjistrimit për Dyqanin e Pavarur Tregtar "M.", datë: 12.06.2000, Certifikata e numrit fiskal, ... , datë: 21.05.2010, Aplikimi për Kredi Individuale, datë:20.11.2008, Vërtetim nga N.Sh. Stacioni i Autobusëve- Prishtinë, për Sh. A., në cilësi të dëshmitarit ka dëgjuar R. A., dhe palët ndërgjyqëse.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë në prova dhe ligj dhe si e tillë edhe është refuzuar.

Nga provat të cilat u administruan në shqyrtimin gjyqësor gjykatës i rezultoi të jetë e provuar se paditësi më datën 12.12.2008, ka autorizuar të paditurin Sh. A., që në emër të tij dhe në llogarinë e tij, paluajtshmëritë ... , në sipërfaqe prej 5000 m2 dhe ... , në

sipërfaqe prej 650 m2, ZK S., mund të vejë në hipotekë në bankë për marrjen e kredisë dhe tërheqjen e të njëjtës nga hipoteka.

Pas marrjes së këtij autorizimi, i padituri Sh. A., me të paditurën B. K. T., me seli në Prishtinë, kontratën mbi hipotekën nr..., të datës 20.12.2008, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Lipjan nr. ... , të datës 23.12.2008. Sipas nenit 3 par. 1 të kësaj kontrate, për të siguruar detyrimet që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. ... , pengdhënësi garanton me pasurinë e tij të paluajtshme, të cilën e lënë peng dhe në të cilën vendoset hipoteka në favor të pengmarrësit dhe atë: tokë, me sipërfaqe prej 5650 m2, në Certifikatën me numër ... dhe me numër të ngastrave ... dhe ... , vendi i quajtur “Sh. P.”, ZK S. , Komuna e Lipjanit, pronë e B. U., vlera totale 148,000,00€.

Kjo hipotekë është regjistruar në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme në Zyrën Komunale të Kadastrit në Lipjan, me nr. ... , me datë 26.12.2008.

Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike ashtu që duke i kualifikuar faktet e çështjes në kuptim të normave materialo juridike si në vijim vendosi të refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë.

Me Neni 1 (Qëllimi dhe Zbatimi) par.1 të Ligji Nr. 2002/ 4 Për Hipotekat është përcaktuar se ky ligj përcakton mjetet për krijimin e hipotekave, efektet e tyre ndërmjet palëve në një kontratë të tillë, efektet e tyre ndaj personave të tretë, dhe mjetet me anë të te cilave, hipotekat e shoqërive tregtare mund të ekzekutohen nëpërmjet procedurave jashtë-gjyqësore në rast të mospërbushjes sipas kushteve të dokumentit të hipotekës.

Me Neni 3 (Objekti i Hipotekës) par. 1. Të po të njëjtit ligj është përcaktuar se objekti i hipotekës mund të jetë prona e patundshme ose një e drejtë e saj me anë të së cilës pronari mund ta posedojë brenda suazave të përcaktuara me ligj.

Ndërsa me nenin 5 (Dokumenti i Hipotekës) të po të njëjtit ligj është përcaktuar se për të qenë i vlefshëm, dokumenti i hipotekës duhet të jetë me shkrim dhe i vërtetuar në të njëjtën mënyrë si transaksionet e tjera që kanë të bëjnë me pronat e paluajtshme në

përputhje me legjislacionin në fuqi. Dokumenti i vlefshëm i hipotekës do të përfshijë: (a) emrin, adresën dhe të dhënat e pengdhënësit dhe pengmarrësit; (b) përshkrimin e detyrimeve të siguruara me hipotekë, ose, nëse detyrimi është parashtruar në një marrëveshje të veçantë kryesore, referimin e saktë të marrëveshjes kryesore; (c) përshkrimin e mjaftueshëm që në mënyrë të arsyeshme e identifikon kolateralin e hipotekës, duke përfshirë numrin kadastral të pronës së paluajtshme, dhe emrin e komunës ku ndodhet pasuria e patundshme; (d) fletën poseduese përkatëse, ose ekuivalentin; (e) lejen përkatëse të ndërtimit, nëse ka; (f) lejen përkatëse të shfrytëzimit, nëse ka; (g) shumën maksimale të detyrimit financiar ose detyrimet e mundshme të ardhme financiare të siguruara me hipotekë; (h) deklaratën me shkronja të zeza të spikatura që tregon se procedura e ekzekutimit të hipotekës mund të çojë në marrjen e pasurisë dhe dëbimin pengdhënësit nga prona; (i) mënyrat për dërgimin e dokumenteve pengdhënësit në rast të mospërbushjes së detyrimit ose procedurave të ekzekutimit së pasurisë të lënë peng; (j) datën kur është nënshkruar dokumenti i hipotekës; nënshkrimet e autorizuara nga ose në emër të pengdhënësit dhe të pengmarrësit; (k) dispozitat të tjera që mund të kërkohen nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.

Ndërsa, me nenin 26 (Kur kontrata quhet e lidhur?) të LMD të vitit 1978 është përcaktuar se Kontrata quhet e lidhur kur palët kontraktuese të jenë marrë vesh mbi pjesët përbërëse esenciale të kontratës.

Me nenin 46 (Si duhet të jetë objekti i detyrimit) të pot ë njëjtit ligj është përcaktuar se detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, bërja, mosbërja, ose durimi. Ai duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar respektivisht i caktueshëm.

Kurse me nenin 47 (Nuliteti i kontratës për shkak të objektit) të pot ë njëjtit ligj është përcaktuar se kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është nul.

Me nenin 51 (Baza e lejueshme) të këtij ligji është përcaktuar se secili detyrim kontraktues duhet të ketë bazën e lejueshme. Baza është e palejueshme po që se është në

kundërshtim me parimet e rregullimit shoqëror, përcaktuara në kushtetutë me dispozitat e dhunshme dhe me rregullat e moralit të shoqërisë vetëqeverisëse socialiste.

Ndërsa me nenin 111 (Kur kontrata është e rrëzueshme) të këtij ligji është përcaktuar se Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar në këtë ligj ose me dispozitë të veçantë.

Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar pasi që sipas vlerësimit të gjykatës i padituri Sh. A., në pajtim me autorizimin të cilën e ka pas nga paditësi, ka krijuar marrëdhënien kontraktuese përmes kontratës për hipotekën me të paditurën B. K. T., në pajtim me dispozitat ligjore.

Sipas vlerësimit të gjykatës marrëdhënia juridike civile e krijuar në mes të paditurve Sh. A. dhe B. K.T. në rastin konkret është krijuar në bazë të një kontrate ku palët kontraktuese kanë përcaktuar të drejta dhe detyrimet e tyre.

Në vlerësimin e gjykatës kjo marrëdhënie kontraktuese është krijuar në tërësi duke i respektuar kushte e përgjithshme për lidhjen e kontratës dhe atë: aftësia punuese e palëve kontraktues, (aftësia e veprimit gjegjësisht mosha madhore), vullneti i palëve, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Në rastin konkret palët kontraktuese kanë respektuar edhe kushte e veçanta e që bëhet fjalë për formën e kontratës edhe legalizimin e kontratës.

Kjo gjykatë vlerëson se e paditura B. K. T. në bazë të dokumentacionit të ofruar nga i padituri Sh. A. , ku është përfshirë edhe autorizimi i paditësi, dhe se e njëjta ka bërë edhe regjistrimin e hipotekës konform dispozitave ligjore për regjistrimin e hipotekës dhe në këtë drejtim nuk ekziston keqbesimi nga ana e të paditurës B. K. T. Andaj, pretendimet në padi në këtë drejtim, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara dhe të njëjtat nuk i mori parasysh me rastin e vendosjes.

Gjykata shqyrtoi pretendimin e të autorizuarit të paditësit se i padituri Sh. A., nuk ka pasur autorizim për marrjes e kredisë provat, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është



i pathemeltë, për faktin se autorizimi me të cilën ishte lidhur kontrata mbi hipotekën ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Autorizimi në përmbajtje është specifik, konkret dhe i qartë, duke i dhënë tagër të autorizuarit që parcelat e autorizim dhënësit me numër të ngastrës ... dhe ... ZK S., mund të i vej në hipotekë në bankë me qëllim të marrjes së kredisë. Pra, nga përmbajtja e autorizimit konsiderohet se i autorizuari ka pas tagër të plotë që paluajtshmëritë e lartcekura që i vendos si hipotekë në bankë me qëllim të marrjes së kredisë.

Gjykata në cilësi të dëshmitarit ka dëgjuar R. A. dhe palët ndërgjyqëse, mirëpo nga deklaratimet e tyre erdhi në përfundim se ato deklarata kishin të bëni me marrëdhëniet afariste ndërmjet tyre në çështje tjera juridike.

Gjykata analizoi edhe pretendimet dhe deklaratimet tjera të palëve ndërgjyqëse, si dhe provat e administruara në shqyrtim kryesor, por të njëjtat nuk i elaboroi në këtë vendim dhe nuk i morri për bazë pasi që nuk patën ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, vendosi duke u bazuar në nenin 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Bazuar në arsyet e cekura më lartë, konform nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.194/2011, me datë 29.02.2024

Gjyqtari  
Përparim Zeka

**UDHËZIMI PËR TË DREJTËN E ANKIMIMIT:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.